



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.218 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Në datën 06.07.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1824, datë 27.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.398 (86-2020-459), datë 20.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a, 615/a të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS: “BIOFERMA RRAMILLI 04” SH.P.K

PADITUR: Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë

PERSONI I TRETË: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Avokatura e Shtetit

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- Rrethanat e Çështjes

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse “BIOFERMA RRAMILLI 04” SH.P.K, është person juridik dhe ushtron veprimtarinë e “mbarështimit të kafshëve, gjedhëve të racave të ndryshme”.

2. Nga ana e palës së paditur, është ushtruar kontroll pranë palës paditëse dhe kanë konstatuar se pranë palës paditëse ka mbi 2 vjet që nuk është ushtruar kontroll dhe rezulton se janë kontrolluar 232 krerë gjedhë për tuberkuloz, duke e futur fermën në karantinë dhe sipas procesverbalit datë 23.03.2018 ka rezultuar se : 192 kafshë janë pozitiv, 11 kafshë të dyshimta dhe 29 kafshë negative.

3. Si përfundim DB Durrës i ka kërkuar Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kërkesën për miratimin e fondit të dëmshpërblimit për 172 krerë, në shumën 24.154.650 lekë, në përputhje me VKM nr.408/2013 për dëmshpërblimin për shkak të eliminimit/ngordhjes së kafshëve prej tuberkulozit.

4. Nga ana e palës paditëse është kërkuar vazhdimisht dëmshpërblimi për 282 krerë gjedhë të infektuar me TBC, por nga ana e palës së paditur Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë me shkresën nr.51/1 prot., datë 20.12.2018, i ka kthyer përgjigje negative.

5. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1824, datë 27.05.2019 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit “BIOFERMA RRAMILLI 04” SH.P.K.

Konstatimin i paligjshmërisë së pjesshme akti nr.51/1 datë 20.12.2018 të palës së paditur Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë.

Detyrimin e palës së paditur Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë për të dëmshpërblyer paditësin për 172 krerë, referuar procesverbalit nr.554 prot., datë 12.05.2018 në shumën 24.154.650 lekë.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj si të pabazuar në ligj dhe në prova.

7. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.398 (86-2020-459), datë 20.02.2020 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1824, datë 27.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. Më datë **10.06.2020** Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Gjykata Administrative e Apelit ka interpretuar në mënyrë të gabuar legjislacionin në fuqi, pasi nga ana e paditësi janë shkëlur shkronjat “ç” dhe “dh” të VKM nr.408 datë 08.05.2013 “Për dëmshpërblimin e kafshëve të eliminuara”.*
- *Gjykata ka keq interpretuar ligjin, pasi edhe pse eliminimi është bërë me kërkesë të autoriteti kompetent, kjo nuk do të thotë se subjekti duhet të përfitojë dëmshpërblim, pasi është vetë fajtor paditësi.*
- *Është e vërtetuar se shfaqja e sëmundjes së kafshëve TBC është bërë si pasojë e fajësisë së vetë pronarit të kafshëve, i cili ka blerë kafshë me status shëndetësor të*

panjohur, duke shkaktuar në këtë mënyrë përhapjen e sëmundjes edhe tek kafshët e tjera në fermë.

- *Ekzekutimi i menjëhershëm do të sillte pasoja të ekonomike për institucionin tonë, duke qenë një vlerë e konsiderueshme.*

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

9. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

10. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

11. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

12. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

13. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimit nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

14. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

15. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

17. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

18. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

19. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

20. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve

Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë.

21. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

22. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1824, datë 27.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr.398 (86-2020-459), datë 20.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1824, datë 27.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr.398 (86-2020-459), datë 20.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit, të paraqitur nga Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.222 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Në datën 06.07.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ndërmarrja “MEICO”

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1918 (80-2017-1958), datë 08.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2264, datë 15.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS: Shpëtim Haka

PADITUR: Ministria e Mbrojtjes
Ndërmarrja “MEICO”
Shoqëria “Albademil” sh.p.k etj

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- Rrethanat e Çështjes

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Shpëtim Haka, është në marrëdhënie gjinie, konkretisht vëlla-motër me shtetasen Maltina Haka, e cila ka mbetur e plagosur rëndë nga ngjarja e ndodhur në fshatin Gërdec.

2. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.1918 (80-2017-1958), datë 08.05.2017 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Ndërmarrja “MEICO” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k, ti shpërblejnë solidarisht paditësit Shpëtim Haka vlerën e dëmit si vijon dëm pasuror 5.700.000 (pesë milion e shtatëqind mijë) lekë.

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2264, datë 15.07.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1918 (80-2017-1958), datë 08.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Më datë **18.06.2020** Ndërmarrja “MEICO”, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Gjykata në kundërshtim me provat e paraqitura në gjykim ka arritur në konkluzionin se Ndërmarrja “MEICO” legjitimohet pasivisht, pavarësisht se edhe nga vendimi penal edhe nga ai civil, provohet se aktiviteti është kryer nga Shoqëria “Albademil” shpk dhe kompania Amerikane SAC.*
- *Është jashtë logjike të arrihet në konkluzionin se aktiviteti i cili ka shkaktuar aksidentin ka ardhur si pasojë e bashkëpunimit me arritjen e qëllimi të përbashkët, ku qëllimi i secilit subjekt është krejtësisht i ndryshëm dhe Ndërmarrja “MEICO” nuk nuk ka qenë pjesë e procedurave të tjetërsimit të armatimit.*
- *Një tjetër gabim i gjykatës është fakti se nuk merr në shqyrtim pretendimet e palëve të paditura për parashkrimin padisë, pasi bazuar në nenin 112 të Kodit Civil nuk është ushtruar brenda afateve.*
- *Edhe akti i ekspertimit ka gabime në përllogaritje pasi nuk jemi dakord me përllogaritjen e dëmit pasuror me pagën mesatare të vitit 2008, e cila për ne është abuzive dhe në dëm të shtetit.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda për shkak të vlerave të mëdha dhe do të shkojmë drejt falimentimit.*

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ndërrmarja “MEICO”, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ndërrmarja “MEICO”, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO”, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

16. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO” kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

17. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO” nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ndërrmarja “MEICO”.

18. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

19. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ndërrmarja “MEICO”, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1918 (80-2017-1958), datë 08.05.2017 të Gjykatës Administrative

të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2264, datë 15.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1918 (80-2017-1958), datë 08.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2264, datë 15.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ndërrmarja “MEICO”.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.223 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Në datën 06.07.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.4635 (80-2016-4670), datë 10.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 308, datë 12.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a, 615 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS: Rudin Qehajaj

PADITUR: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- Rrethanat e Çështjes

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Rudin Qehajaj, ka punuar pranë palës së paditur prej 2004 dhe prej 2015 është emëruar “Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Akuakulturës...”, si dhe gëzon statusin e nëpunësit civil.

2. Nga ana e palës së paditur është realizuar një audit dhe në përfundim janë konstatuar shkelje nga ana e palës paditëse dhe pasi është realizuar procedura disiplinore në përfundim me vendimin nr.22 datë 29.06.2016, është larguar nga shërbimi civil.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.4635 (80-2016-4670), datë 10.10.2016 ka vendosur:

Pranimin e padisë së paditësit Rudin Qehajaj.

Shfuqizimin e vendimit nr.21 datë 29.06.2016 të Komisionit të Disiplinës të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.

Shfuqizimin e vendimit nr.22 datë 29.06.2016 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.

Detyrimin e palës së paditur Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave që të kthejë paditësin në vendin e mëparshëm të punës si përgjegjës i Sektorit të Akuakulturës dhe Ujrave të Brendshme.

Detyrimin e palës së paditur Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, t'i paguaj pagën paditësit, nga momenti i ndërprerjes së saj deri në rikthimin në vendin e mëparshëm të punës.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 308, datë 12.02.2020 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.4635 (80-2016-4670), datë 10.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **19.06.2020** Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka zbatuar në mënyrë të gabuar legjislacionin në fuqi, pasi interpretimi i saj është në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*
- *Gjykata shprehet se pala e paditur nuk ka provuar shkaqe/rrethanat e kryerjes së shkeljes dhe pasojat e ardhura prej saj, por pala e paditur ka paraqitur Raportin e Auditit që faton shkeljet e paditësit.*
- *Në vendimin e saj, gjykata ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 60 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i cili përcakton se për masat disiplinore merret në konsideratë parimi i përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore.*
- *Ky vendim është i pabazuar dhe ekzekutimi i këtij vendimi në këtë fazë do të sillte dëm interesave të shtetit.*

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor

të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtarë apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e

tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili ka parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tij kërkon mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar

njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4635 (80-2016-4670), datë 10.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 308, datë 12.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4635 (80-2016-4670), datë 10.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 308, datë 12.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit, të paraqitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 8/247 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Në datën **06.07.2020** mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Dega e Doganës Durrës

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.3590, datë 27.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS: Shoqëria “Bankers Petrolum Albania ltd”

PADITUR: Dega e Doganës Durrës

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse shoqëria “Bankers Petrolum Albania ltd”, ushron aktivitetin në kryerjen e operacioneve të hidrokarbureve.

2. Nga ana e palës së paditur Dega e Doganës Durrës, nuk është marrë në konsiderat kërkesa e palës paditëse shoqëria “Bankers Petrolum Albania ltd” për rimbursimin e taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit, vendim ky i cili është lënë në fuqi edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës**, me vendimin nr.1485, datë 03.11.2014 ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.3590, datë 27.07.2017 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.1485, datë 03.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Pranimin e kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Dega e Doganës Durrës të përmbushë kushtëzimin e nenit 249 të Kodit Doganor, duke rimbursuar paditësin për detyrimin e importit për Taksën e Karbonit dhe Taksën e Qarkullimit, për periudhën 16 Maj 2012 deri në 24 Janar 2014, në shumën 1.767.176.360 lekë (Taksë Qarkullimi) dhe Taksën e Karbonit në vlerën 729.997.660.20 lekë, si detyrim importi të përjashtuara nga ligji.

6. Më datë **18.04.2019** Dega e Doganës Durrës, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Duke mos qenë dakort me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, kemi ushtruar rekurs pranë Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë me nr.11850 prot., datë 28.07.2017.*
- *Rekurs ka ushtruar edhe Avokatura e Shtetit me nr.13830 prot., datë 11.09.2017 dhe kundër rekurs pala paditëse.*
- *Me shkresën nr.6803 prot., datë 12.04.2019, shoqëria “Bankers Petrolum Albania ltd” kërkon ekzekutimin vullnetar të këtij vendimi.*
- *Ekzekutimi i këtij vendimi do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm ndaj administratës doganore, për të cilën çështja nuk është zgjidhur nga Gjykata e Lartë.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Dega e Doganës Durrës, është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

15. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Dega e Doganës Durrës, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Dega e Doganës Durrës, të cilat kanë parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tyre kërkojnë mospranimin e kërkesë si të pabazuar në ligj.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Dega e Doganës Durrës kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe ligjore që kanë të bëjnë me drejtësinë, bazueshmërinë në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18. Për sa i përket pretendimit kryesor dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Dega e Doganës Durrës ka parashtruar dhe argumentuar për rrethanën konkrete të çështjes se jemi përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Dega e Doganës Durrës.

19. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet një kërkim dhe pretendim i mbështetur në ligj, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, duke parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20. Gjithashtu ky Kolegji vlerëson të theksojë se marrja e masës së pezullimi të një vendim të formës së prerë është e lidhur ngushtësisht me zbatimin e dispozitave konkrete mbi ankimin apo rekursin dhe shkaqeve për paligjshmëri që parashtrohen qartazi në to, konkretisht neni 58 të ligjit procedural nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, respektimi i të cilit është detyrim për çdo gjykatë apo palë ndërgjyqëse. Mënyra e parashtrimit nga pala të pretendimeve ligjore në

shkaqet për rekurs dhe, në veçanti, në kërkesën për pezullim, të ballafaquara me bazueshmërinë ligjore të vendimeve gjyqësore, janë kërkesa të detyrueshme, nga të cilat varet edhe zgjidhja e çështjeve objekt shqyrtimi.

21. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Dega e Doganës Durrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3590, datë 27.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.3590, datë 27.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Dega e Doganës Durrës.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ervin PUPE

ANËTAR
Ilir PANDA

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.30/303 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Në datën **06.07.2020**, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ministria e Brendshme
Bashkia Tiranë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.466, datë 20.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.4177, datë 19.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS: Hajdar Shtishi

PADITUR: Ministria e Brendshme
Bashkia Tiranë etj

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Hajdar Shtishi, i është marrë për efekt të shpronësimit publik një sipërfaqe toke prej 1700 m², për rehabilitimin e varrezave të Sharrës.

2. Nga ana e palës së paditur sipërfaqja prej 1700 m² është shpronësuar në vlerën prej 448 lekë/m², sipas VKM nr.152 datë 19.03.2014 “Për shpronësimin për interes publik....”..

3. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.4177, datë 19.09.2016 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të padisë së paditësit Hajdar Shtishi.

Detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë paditësit Hajdar Shtishi diferencën e vlerës së shpronësimit për pasurinë nr.26/17 ndodhur në Tufinë Tiranë, Zona Kadastrale 3426, me sipërfaqe toke e llojit truall prej 1.700 m², në shumën prej 1.921.000 lekë.

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.466, datë 20.02.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.4177, datë 19.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Më datë **23.05.2019** Ministria e Brendshme, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Ministria e Brendshme nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje dhe nuk mund të ngarkohet me detyrime dhe nuk është nxjerrë asnjë akt që ti sjell pasoja paditësive, nuk është kryer asnjë veprim administrativ që të jetë refuzuar apo heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë.*
- *Sipas VKM nr.152 datë 19.03.2014 “Për shpronësimin për interes publik....”, i referohet interesit të drejtpërdrejtë që Bashkia Tiranë ka në këtë proces.*
- *Po sipas VKM nr.152 datë 19.03.2014 “Për shpronësimin për interes publik....”, përcaktohet se vlerat përballohen nga Bashkia Tiranë, miratuar në buxhetin e vitit 2014.*
- *Kjo padi është parashkruar dhe është ngritur jashtë afateve ligjore*
- *Sa më sipër kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.*

7. Më datë **06.06.2019** Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Bashkia Tiranë ka depozituar rekursin nr.prot 10668 datë 05.03.2019.*
- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi paditësi nuk paraqiti asnjë provë që të provonte pretendimet e tij dhe të kundërshtonte argumentat tona.*
- *Bashkia Tiranë nuk ka kryer asnjë veprim në kundërshtim me ligjin, përkundrazi ka vepruar në përputhje me kërkesat që parashikon ligji nr.8561 datë 22.12.1999 “për shpronësimet për interes publik”.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

14. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë, është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

16. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

17. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë, të cilët nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

18. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë kërkojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe ligjore që kanë të bëjnë me legjitimitetin pasiv dhe me drejtësinë e bazueshmërinë në ligj të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

19. Për sa i përket pretendimit kryesor dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë kanë parashtruar dhe argumentuar për rrethanën konkrete të çështjes se jemi përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë.

20. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve konkrete, specifikimin e pozitës së palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen ndaj subjektit konkret në çështjen në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet një kërkim dhe pretendim i mbështetur në ligj, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, duke parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

21. Gjithashtu ky Kolegji vlerëson të theksojë se marrja e masës së pezullimi të një vendim të formës së prerë është e lidhur ngushtësisht me zbatimin e dispozitave konkrete mbi ankimin apo rekursin dhe shkaqeve për paligjshmëri që parashtrohen qartazi në to, konkretisht neni 58 të ligjit procedural nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, respektimi i të cilit është detyrim për çdo gjykatë apo palë ndërgjyqëse. Mënyra e parashtrimit nga pala të pretendimeve ligjore në shkaqet për rekurs dhe, në veçanti, në kërkesën për pezullim, të ballafaquara me bazueshmërinë ligjore të vendimeve gjyqësore, janë kërkesa të detyrueshme, nga të cilat varet edhe zgjidhja e çështjeve objekt shqyrtimi.

22. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.466, datë 20.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.4177, datë 19.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.466, datë 20.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.4177, datë 19.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ervin PUPE

ANËTAR
Ilir PANDA

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 33/307 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Ilir PANDA**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 06.07.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Departamenti i Administratës Publike

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1826 (1850), datë 02.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS: Lek Tushaj

PADITUR: Departamenti i Administratës Publike

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- Rrethanat e Çështjes

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Lek Tushaj, ka qenë në marrëdhënie pune pranë Këshillit të Ministrave, në pozicionin Koordinator

në Departamentin e Zhvillimit të Politikave dhe Kordinimit, si dhe me vendim nr.2995/11 datë 19.12.2005 është liruar nga detyra dhe ka kaluar në listë pritje.

2. Paditës gjatë kohës së qëndrimit në listë pritje ka evidentuar se DAP ka shpallur vende të lira pune në pozicionin e paditësi dhe i ka bërë kërkesë edhe DAP edhe Komisionit të Shërbimit Civil për të anuluar procedurat e konkurimit, për pozicionin Kordinatorit në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Kordinimin Strategjik me Donatorët në Këshillin e Ministrave.

3. Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr.5 datë 19.01.2007 ka vendosur: Pranimin e kërkesës së z.Lek Tushaj.

Anullimin e procedurave të konkurimit për pozicionin e Kordinatorit në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Kordinimin Strategjik me Donatorët në Këshillin e Ministrave.

Detyrimin e DAP për të nxjerrë aktin e emërimit për një nga kandidaturat e listës së pritjes që plotëson kërkesat e veçanta për vendin e lirë për z.Tushaj.

4. Vendimi i sipërcituar është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.283 datë 28.05.2017 dhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr.1438 datë 14.12.2007, dhe mbi bazën e urdhërit të ekzekutimit është nxjerrë akti administrativ nr.2211/3 datë 28.03.2008 duke e emëruar palën në pozicionin e Kordinatorit në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Kordinimin Strategjik me Donatorët në Këshillin e Ministrave.

5. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin pasi ka vonuar në nxjerrjen e aktit të emërimit, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

6. **Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Tiranë**, me vendimin nr.5760, datë 29.06.2009 vendosi: “Rrëzimin e padisë”.

7. **Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.1773, datë 06.10.2010 vendosi: “Lënien në fuqi të vendimit nr.5760 datë 29.06.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Tiranë”.

8. **Gjykata e Lartë**, me vendimin nr. 00 - 2014 – 3826 (589), datë 06.11.2014 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.1773, datë 06.10.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

9. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.1826 (1850), datë 02.05.2017 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.5760, datë 29.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Tiranë. Pranimin e padisë së paditësit Lek Tushaj. Detyrimin e Departamentit të Administratës Publike, t'i paguajë paditësit shumën prej 1.381.777 lekë.

10. Më datë **27.05.2020** Departamenti i Administratës Publike, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *DAP ka paraqitur pranë kësaj gjykate rekursin nr.3623 datë 31.05.2017, duke parashtruar të gjitha shkeljet e kryera nga Gjykata Administrative e Apelit.*
- *Argumentat e gjykatës në lidhje me themelin e kërtimeve të paraqitura nga paditësi për dëmshpërblimin në lidhje me vonesën e krijuar në nxjerrjen e aktit të emërimit në zbatim të vendimit të KSHC nr.5 datë 19.01.2007, janë haptazi në kundërshtim me K.Pr.Civile, duke shkelur nenet 14, 16 dhe 28.*
- *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë një vendim në pajtim të plotë e dispozitat ligjore dhe për këtë arsye duhej të lihej në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi pala e paditur është ngarkuar me një dëm të paqenë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda deri sa të shprehet Gjykata e Lartë.*

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

11. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

12. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

13. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

14. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimin administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

15. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

16. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

17. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Departamenti i Administratës Publike, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

19. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Departamenti i Administratës Publike, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

20. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Departamenti i Administratës Publike, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

21. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Departamenti i Administratës Publike kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

22. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Departamenti i Administratës Publike nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Departamenti i Administratës Publike.

23. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

24. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Departamenti i Administratës Publike, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1826 (1850), datë 02.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1826 (1850), datë 02.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Departamenti i Administratës Publike.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 128/469 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Irir PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Në datën 06.07.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2176, datë 10.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili la në fuqi me vendimin nr.1145, datë 28.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS/KUNDËR I PADITUR: Gjike Stramarko

PADITUR/KUNDËR-PADITËS: Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Gjike Stramarko, pretendon se është pronar i një pasurie me sipërfaqe 300 m² i një objekti 3 katësh të ndodhur në Dhërmi, në venin Polo Potamo dhe origjina e kësaj prone është vendimi nr.381 datë 18.05.1997 të KKKP Vlorë në emër të Foto Stramarkos për një sipërfaqe trualli 1000 m² + 600 m² në fshatin Dhërmi.

2. Me urdhërin nr. 70 datë 13.02.2014 të Kryeministrit “Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore” është ngritur Task Forca e cila ka konstatuar se vendimi nr.381 datë 18.05.1997 të KKKP Vlorë është absolutisht i pavlefshëm dhe ka rekomanduar IKMT për zbatim.

3. Nga ana e palës së paditur IKMT në datë 10.04.2014, ka ushtruar kontroll pranë paditësit dhe ka konstatuar kundravajtjen objekt i kundërligjshëm 4 kat me konstruksion B/A dhe është marrë vendimi nr.31 datë 10.04.2014 “Për prishjen e objektit”.

4. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.1145, datë 28.07.2015 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së bërë nga paditësi Gjike Stramarko si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Shfuqizimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ vendim nr.31 datë 10.04.2014 i INUK “Për prishje e objektit”.

Konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga pala e paditur në datën 13.04.2014 për shembjen e objektit.

Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin Gjike Stramarko në shumën e përcaktuar nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme sipas aktit të ekspertimit në shumën prej 308.805.000 (treqind e tetë milion e tetëqind e pesë mijë) lekë.

Rrëzimin e padisë së bërë nga inspektoriat i Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit Tiranë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

6. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2176, datë 10.07.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1145, datë 28.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

7. Më datë **14.10.2019** Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Gjykatat nuk kanë marrë parasysh prapësimet e palës së paditur në kundërshtim me nenin 6, 16 dhe 309 të K.Pr.Civile dhe është mbështetur vetëm në provat dhe argumentat e palës paditëse.*
- *Ky vendim i cili përcakton si shkaktues të dëmit IKMT është i pambështetur në prova, ligj dhe në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.12 datë 14.09.2007.*
- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në kundërshtim me nenin 608 të Kodit Civil, pasi paditësi nuk arriti të provojë ligjshmërinë e veprimeve të tij dhe akti i ekspertimit është i paplotë, i njëanshëm, i pabazuar dhe arsyetuar sipas*

kërkesave të ligjit dhe referuar nenit 224 e vijues të K.Pr.Civile i bënë këto vendime të cënueshme.

- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme, për kthimin e kësaj shume në buxhetin e shtetit në rast ndryshimi të këtyre vendimeve.*

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

14. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Avokatura e Shtetit, është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

16. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Avokatura e Shtetit, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

17. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Avokatura e Shtetit, i cili ka parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tij kërkon mospranimin e kërkesë si të pabazuar në ligj.

18. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Avokatura e Shtetit kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe ligjore që kanë të bëjnë me drejtësinë, bazueshmërinë në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

19. Për sa i përket pretendimit kryesor dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Avokatura e Shtetit ka parashtruar dhe argumentuar për rrethanën

konkrete të çështjes se jemi përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Avokatura e Shtetit.

20. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet një kërkim dhe pretendim i mbështetur në ligj, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, duke parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

21. Gjithashtu ky Kolegji vlerëson të theksojë se marrja e masës së pezullimi të një vendim të formës së prerë është e lidhur ngushtësisht me zbatimin e dispozitave konkrete mbi ankimin apo rekursin dhe shkaqeve për paligjshmëri që parashtrohen qartazi në to, konkretisht neni 58 të ligjit procedural nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, respektimi i të cilit është detyrim për çdo gjykatë apo palë ndërgjyqëse. Mënyra e parashtrimit nga pala të pretendimeve ligjore në shkaqet për rekurs dhe, në veçanti, në kërkesën për pezullim, të ballafaquara me bazueshmërinë ligjore të vendimeve gjyqësore, janë kërkesa të detyrueshme, nga të cilat varet edhe zgjidhja e çështjeve objekt shqyrtimi.

22. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2176, datë 10.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili la në fuqi me vendimin nr.1145, datë 28.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2176, datë 10.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili la në fuqi me vendimin nr.1145, datë 28.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, të paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ervin PUPE

ANËTAR
Ilir PANDA

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.91/481 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Illir PANDA	Anëtar

Në datën 06.07.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1442, datë 05.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a, 615 e vijues të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me :

PADITËS: Shoqëria “Valbona Project Company” sh.p.k

PADITUR: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Komisioni i Prokurimit Publik

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse shoqëria “Valbona Project Company” sh.p.k, rezulton se ka marrë pjesën në procedurën koncesionare me objekt “dhënien me koncesion të HEC-ve mbi kaskadën e lumit Curraj, Rrethi Tropojë”.

2. Nga ana e palës së paditur në datë 07.03.2011, me shkresën nr.6480/22 është njoftuar pala paditëse Shoqëria “Valbona Project Company” sh.p.k se oferta e tij është kualifikuar dhe vlerësuar në shumën totale prej 98 pikësh.

3. Po në datë 07.03.2011 janë njoftuar bashkimi i operatorëve “Telemenia Alb” shpk & “F.K Generators & Equipments” L.T.D dhe “Melta Inter Industries” L.T.D, se oferta e tyre është skualifikuar, të cilët janë ankuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Kjo procedurë pas disa ankimeve administrative dhe gjyqësor si përfundim është anuluar nga ana e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me urdhrin nr.580 datë 28.07.2011 dhe është kërkuar të rivlerësohen ofertat.

5. Nga ana e autoritetit kontraktues METE me shkresën nr.6480/39 prot., datë 29.07.2011 është njoftuar shoqëria “Valbona Project Company” sh.p.k se është skualifikuar nga kjo procedurë, pasi nuk plotëson kriteret ligjore të kualifikimit.

6. Pala paditëse shoqëria “Valbona Project Company” sh.p.k, ka paraqitur ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i cili me vendimin nr.790 datë 13.09.2011, nuk ka pranuar ankesën përkatëse.

7. Në vijim në datë 05.12.2011 mes Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të operatorëve “Telemenia Alb” shpk & “F.K Generators & Equipments” L.T.D dhe “Melta Inter Industries” L.T.D, është lidhur kontrata koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Curraj ,Tropojë.

8. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

9. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.2463, datë 07.05.2015 ka vendosur:

Pranimin e pjesëshëm të kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Komisioni i Prokurimit Publik ti kthejë palës paditëse, shoqërisë “Valbona Project Company” sh.p.k, shumën prej 130.700,3 (njëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind presje tre) euro.

Mospranimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.

10. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1442, datë 05.04.2018 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.2463, datë 07.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në këtë mënyrë:

Pranimin e kërkesë padisë.

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhërit nr.580, datë 28.07.2011 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ “Njoftim” nr.6480/39 prot., datë 29.07.2011, me të cilin është njoftuar skualifikimi i shoqërisë “ Valbona Project Company” në konkurimin për dhënien me konçesion të hidrocentraleve mbi lumin Curraj.

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ “Njoftim” nr.6480/38 prot., datë 29.07.2011, me të cilin është njoftuar kualifikimi dhe klasifikimi në vend të parë, i Bashkimit të Operatorëve “ Telemenia Alb” sh.p.k, “F.K Generators & Equipments” L.t.d, dhe “Melta Inter Industries” L.t.d, si dhe Njoftimi i Fituesit të këtij subjekti, lidhur me procedurën e prokurimit për dhënien me konçesion të hidrocentraleve mbi lumin Curraj.

Shfuqizimin e vendimit nr.709, datë 13.09.2011 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Detyrimin e palës së paditur Komisioni i Prokurimit Publik, t’i kthejë palës paditëse, shoqërisë “ Valbona Project Company” sh.p.k, shumën prej 130.700,3 (njëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind presje tre) euro.

11. Më datë **30.10.2019** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Të dy gjykatat nuk kanë respektuar elementët thelbësor procedural të cilat lidhen me zhvillimin e “një procesi të rregullt ligjor”, pasi vendimi i shkallës së parë është në kundërshtim me nenin 12 pika 1 të ligjit nr.49/2012 dhe kjo shkelje procedurale nuk është rregulluar nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit.*
- *Gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e padisë për disa pika të kërimit dhe ka pranuar vetëm pikën 4 të objektit të padisë dhe duke qenë se kemi një vendim jopërfundimtar, afatet e ankimit janë 5 ditë dhe nga ana formale gjykata nuk duhet të kishte pranuar këtë ankim dhe po ashtu Gjykata e Apelit duhet të konstatonte si shkelje procedurale.*
- *Shkaqet që ne si palë e paditur kundërshtojmë vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me themelin e çështjes objekt shqyrtimi, i kemi detajuar në rekursin e paraqitur pranë kësaj gjykate të cilat presin të shqyrtohen.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme, pasi pavlefshmëria e akteve me të cilat është njoftuar kualifikimi dhe klasifikimi i operatorit fitues, do të conte në pavlefshmërinë e të gjitha akteve dhe të procedurës koncesionare.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

12. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

13. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

14. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

15. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

16. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

17. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

18. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

20. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

21. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilat kanë

parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tyre kërkojnë mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

22. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

23. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

24. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

25. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1442, datë 05.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1442, datë 05.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 154/519 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Ilir PANDA**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 06.07.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Akademia e Sigurisë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2298, datë 23.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr.49/2012, ligji nr.108/2014, VKM nr.750/2015, VKM nr.185/2015, Rregullorja e Akademisë së Sigurisë

Në çështjen me :

PADITËS: Algert Çekrezi

PADITUR: Akademia e Sigurisë

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Algert Çekrezi, ka qenë me detyrë Specialist për hetimin e krimeve në Drejtorinë e Policisë Berat dhe sipas urdhërit nr.459 datë 10.05.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

është urdhëruar zhvillimi i trajnimit për ngritjen në gradën “Nënkomisar” për periudhën 10.05.2016-19.06.2016.

2. Me urdhërin nr.983 datë 12.10.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është urdhëruar fillimi i studimeve të ciklit të parë “Bachelor” në Akademinë e Sigurisë për vitin akademik 2016-2017 dhe ku figuron edhe paditësi.

3. Në vijim me urdhërin nr.179 datë 05.07.2017 të Drejtorit/Rektorit të Akademisë së Sigurisë është urdhëruar që Nënkomisar Algert Ymer Cekrezi, student në vitin e dytë të përjashtohet nga Fakulteti I Sigurisë dhe Hetimit me motivacionin “për plotësim të numrit të mungesave”.

4. Mbi bazën e urdhërit të sipërcituar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me urdhërin nr.206/1 datë 24.07.2017 është shfuqizuar urdhëri për dhënien e gradës Nënkomisar dhe është kthyer në të njëjtin vend pune.

5. Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe pasi ka shteruar ankimin administrativ, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.382 (391), datë 08.02.2018 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë.

Shfuqizimin e urdhërit nr.179 datë 05.07.2017 të Akademisë së Sigurisë për përjashtimin e paditësit Algert Çekrezi nga Fakulteti i Sigurisë dhe i Hetimit në Akademinë e Sigurisë dhe detyrimin e palës së paditur Akademia e Sigurisë që të lejojë paditësinë që të vazhdojë studimet në këtë fakultet.

Shfuqizimin e urdhërit nr.206/1 datë 24.07.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për shfuqizimin urdhërit nr.4226 datë 01.07.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që të sistemojë paditësin në një pozicion që i referohet gradës “Nënkomisar”.

7. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2298, datë 23.07.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.382 (391), datë 08.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. Më datë **17.12.2019** Akademia e Sigurisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Institucioni arsimor i lartë Akademia e Sigurisë ka realizuar rekurs në datë 04.09.2019, në mbështetje të nenit 469 të Kodit të Procedurës Civile.*
- *Pretendimi i palës paditëse për të ushtruar menjëherë të drejtën e fillimit të studimit të viti të ri akademik, sjellin pasojë të rënda për institucionin tonë, pasi sqarojmë që të gjithë procedurat e regjistrimit janë rregulluar nga aktet normuese të policisë së shtetit.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

9. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

10. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

11. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

12. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

13. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

14. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

15. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Akademia e Sigurisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

17. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Akademia e Sigurisë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

18. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Akademia e Sigurisë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

19. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Akademia e Sigurisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

20. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Akademia e Sigurisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Akademia e Sigurisë.

21. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim

dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

22. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Akademia e Sigurisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2298, datë 23.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2298, datë 23.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Akademia e Sigurisë.

Tiranë, më datë 06.07.2020

ANËTAR
Ilir PANDA

ANËTAR
Ervin PUPE

KRYESUES
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 163/531 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot, në Tiranë, më **datë 06.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 531/2019**, që i përket:

KËRKUES: Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: **Aleksandër Kito, etj.**

I PADITUR: **Spitali Universitar Obstretik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar pagimin e dëmshpërblimit pasuror dhe jopasuror për dëmtimin e shëndetit të fëmijës Aleksandër Kito.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, ka vendosur:

“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësve Aleksandër Kito, Aristotel Kito, Julian Memaj, Vasil Kito, Flamur Memaj, Eli Memaj, Orsiol Memaj dhe Dorina Memaj.

Detyrimin e palës së paditur Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” të dëmshpërblejë paditësit Aleksandër Kito, Aristotel Kito, Julian Memaj, Vasil Kito, Flamur Memaj, Eli Memaj, Orsiol Memaj dhe Dorina Memaj për dëmin pasuror dhe jopasuror, të shkaktuar nga dëmtimi i shëndetit të fëmijës Aleksandro Kito gjatë lindjes së tij me datë 26.01.2012, si vijon:

1. *Paditësi Aleksandros Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëmin pasuror në vlerën 3.856.298 lekë.*
 - *Dëmin jopasuror: dëm biologjik në vlerën 3.856.298 lekë; dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149.*
2. *Paditësi Aristotel Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm jopasuror: dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzimet spitalore në vlerën 1.478.452 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzime për përkujdesje në vlerën 10.032.000 lekë, shpenzime për këshillime psikologjike në vlerën 4.680.000 lekë, shpenzime për fizioterapi në vlerën 41.610.000 lekë dhe shpenzime për pajisje ortopedike në vlerën 5.520.000 lekë.*
3. *Paditësja Juliana Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm jopasuror: dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzimet spitalore në vlerën 1.478.452 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzime për përkujdesje në vlerën 10.032.000 lekë, shpenzime për këshillime psikologjike në vlerën 4.680.000 lekë, shpenzime për fizioterapi në vlerën 41.610.000 lekë dhe shpenzime për pajisje ortopedike në vlerën 5.520.000 lekë.*
4. *Paditësi Vasil Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
5. *Paditësja Eli Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
6. *Paditësi Flamur Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
7. *Paditësja Orsiola Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë.*
8. *Paditësja Doriana Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë.*

Rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Shpenzimet gjyqësore dhe ato për vënien në ekzekutim të vendimit në ngarkim të palëve në masën 1/3 paditësit dhe 2/3 pala e paditur.”.

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 2859 (80-2016-2987), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

4. **Kundër vendimit nr. 2590, datë 02.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha

Geraldinë”, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

5. **Avokatura e Shtetit**, në datën 27.12.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Kërkimin tonë e motivojmë me drejtësinë dhe bazueshmërinë në prova e në ligj të vendimeve të të dyja gjykatave të faktit, të cilat Gjykata e Lartë ka mundësinë t'i konstatojë gjatë gjykimit të saj dhe ku haptazi ekziston mundësia që kjo vendimmarrje të ndryshojë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i këtij vendimi do të sillte dëme serioze dhe të pariparueshme e pasoja të rënda, të materializuara në vështirësinë e kthimit të kësaj shume pranë buxhetit të shtetit, në rast të ndryshimit të kësaj vendimmarrje pas ushtrimit të të drejtës së ankimit.*
- *Gjithashtu, nga ana e gjykatës duhet të merret parasysh natyra e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, pozita e palës kreditore dhe asaj debitore si dhe natyra dhe vlera e detyrimit që kërkohet të ekzekutohet.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të

vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 06.07.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 168 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Sot, në Tiranë, më datë **06.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 168/2020**, që i përket:

KËRKUES: Bashkia Bulqizë.

OBJEKTI: Kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, të vendimit gjyqësor me nr. 80-2016-6092, datë 15.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 2493 (86-2019-2845), të datës 24.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479, 615 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shoqëria “Refleks” sh.p.k.

E PADITUR: Bashkia Bulqizë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë shpërblimin për punën e kryer si pasojë e zbatimit të kontratës publike.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 6038 (80-2016-6092), datë 15.12.2016, ka vendosur:

“1. *Pranimin e kërkesëpadisë.*

2. *Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Bulqizë, të përmbushë detyrimin kontraktor në favor të palës paditëse për shumën e palikujduar prej 2.241.736 (dy milion e dyqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë si dhe të paguajë kamatat ligjore mbi këtë shumë deri në datën e ekzekutimit të vendimit, për periudhën nga data 01.08.2006 deri në datën e ekspertimit 26.10.2016. Detyrimi për kamatat ligjore është në shumën 1.377.722 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e dy) lekë.*

3. *Shpenzimet procedurale i ngarkohen palës së paditur.”.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2493 (96-2019-2845), datë 24.09.2019, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 6038, datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

4. **Kundër vendimit nr. 2493 (96-2019-2845), datë 24.09.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Bashkia Bulqizë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes.

5. **Pala e paditur, Bashkia Bulqizë**, në datën 13.01.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6038 (80-2016-6092), datë 15.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2493 (96-2019-2845), datë 24.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Në rast vendimmarrje të ndryshme të Gjykatës së Lartë nga Gjykata Administrative e Apelit, nëse do të ekzekutohej detyrimi, atëherë do të bëhej e pamundur kthimi mbrapsht i shumës, duke qenë se pala paditëse nuk ka aktivitet tregtar.*
- *Duke marrë në konsideratë shumën e madhe objekt ekzekutimi, një ekzekutim i menjëhershëm do të sillte pasoja të pariparueshme në veprimtarinë e Bashkisë Bulqizë.*
- *Nëse vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit do të lihej në fuqi nga Gjykata e Lartë, ekzekutimi i shumës së përcaktuar në vendim mund të realizohet në çdo kohë nga ana e Bashkisë Bulqizë, për shkak të natyrës së këtij institucioni.*
- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është në kundërshtim flagrant me ligjin dhe me praktikën e po kësaj gjykatë, gjë të cilën e kemi argumentuar në rekurs.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të

pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Bashkia Bulqizë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6038 (80-2016-6092), datë 15.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2493 (96-2019-2845), datë 24.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 06.07.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 224 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot, në Tiranë, më **datë 06.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 224/2020**, që i përket:

KËRKUES: **Bashkia Tiranë.**

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2797, datë 02.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3206, datë 16.12.2019.

BAZA LIGJORE: Neni 449, 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: **Elena Sherifi.**

E PADITUR: **Bashkia Tiranë.**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ të palës së paditur, rikthimin në punë të saj si dhe pagimin e pagës deri në momentin e rikthimit në punë.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 2797 (2788), datë 02.06.2016, ka vendosur:

“1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 3221/4 prot., datë 01.02.2016 dhe nr. 4437 prot., datë 10.02.2016, të Bashkisë Tiranë për lirimin e paditëses Elena Sherifi nga Shërbimi Civil.

3. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë që të sistemojë paditësen Elena Sherifi në një pozicion tjetër të shërbimit, të së njëjtës kategori dhe t’i paguajë pagën nga momenti i ndërprerjes e deri në ekzekutimin e këtij vendimi.

4. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.

5. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur”.

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 3206, datë 16.12.2019, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 2797, datë 02.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

4. **Kundër vendimit nr. 3206, datë 16.12.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 2797 (2788), datë 02.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. **Pala e paditur, Bashkia Tiranë**, në datën 22.06.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2797 (2788), datë 02.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 3206, datë 16.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë të pabazuara në ligj dhe në prova, për shkaqet që janë parashtruar në rekurs nga ana e Bashkisë Tiranë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të formës së prerë do të ketë efekte financiare të konsiderueshme për Bashkinë e Tiranës.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit

gjqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të

konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2797 (2788), datë 02.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 3206, datë 16.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 06.07.2020

A N Ë T A R
Illir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 153/515 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Sot, në Tiranë, më **datë 06.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 515/2019**, që i përket:

KËRKUES: Beqir Liti.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit administrativ nr. 76, datë 12.02.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, lënë në fuqi me vendimin nr. 2763, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: **Këshilli i Qarkut Gjirokastër.**

I PADITUR: **Beqir Liti.**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë shumën e përfituar padrejtësisht.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër**, me vendimin nr. 76, datë 12.02.2018, ka vendosur:

“1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

2. Detyrimin e të paditurit Beqir Liti t'i kthejë palës paditës Këshillit të Qarkut Gjirokastër shumën 90.960 (nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë të përfituara padrejtësisht gjatë vitit 2014.

3. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të objekti të saj.”.

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2763, datë 17.10.2019, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 76, datë 12.02.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.”.

4. **Kundër vendimit nr. 2763, datë 17.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Beqir Liti, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 76, datë 12.02.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

5. **Pala e paditur, Beqir Liti**, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë, së bashku me rekursin, edhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 76, datë 12.02.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, lënë në fuqi me vendimin nr. 2763, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë marr në interpretim dhe zbatim të gabuar të dispozitave të Kodit të Punës.*
- *Vendimi duhet të pezullohet për shkak se palës së paditur i vjen një dëm i rëndë e parikuperueshëm nga ekzekutimi i tij.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtruhet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në

shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Beqir Liti, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 76, datë 12.02.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2763, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 06.07.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 97/431 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol SADUSHI	Kryesues
Ervin PUPE	Anëtar
Ilir PANDA	Anëtar

Sot, në Tiranë, më **datë 06.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 431/2019**, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1235, datë 23.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit si dhe vendimit nr. 4335, datë 26.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Sokol Aliaj.

E PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë shpërblimin e rrjedhur nga rezultatet e lidhura me marrëdhëniet e punësimit.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 4335 (80-2016-4340), datë 26.09.2016, ka vendosur:

“1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësit Sokol Aliaj.

2. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit Sokol Aliaj shpërblimin që i takon për sanksionin e vënë në masën 42.472.920 lekë, sipas vendimit nr. 104, datë 02.07.2013, të Degës së Doganës Durrës.

3. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërimit objekt padie si të pabazuar në ligj dhe në prova.

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 1235, datë 23.04.2019, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 4335, datë 26.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me saktësimin e pikës “2” të dispozitivit në këtë mënyrë:

- *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit Sokol Aliaj shumën prej 3.539.410 lekë.”.*

4. **Kundër vendimit nr. 1235, datë 23.04.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 4335 (80-2016-4340), datë 26.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. **Pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**, në datën 25.09.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4335 (80-2016-4340), datë 26.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1235, datë 23.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat dhe për këtë shkak ne kemi ushtruar të drejtën e rekursit.*
- *Gjykatat në vendimin e tyre nuk kanë marrë në konsideratë shkakun për të cilin nuk është përfshirë sanksioni i shoqërisë “Petromanias”, në skemën e shpërndarjes.*
- *Në momentin që shuma e gjobës ka shkuar për llogari të buxhetit të shtetit dhe jo për llogari të autoritetit doganor, ky i fundit nuk ka asnjë kompetencë ligjore të ndërhyjë në këtë shumë.*
- *Gjykatat kanë marrë një vendim në kundërshtim me sa parashikon Udhëzimi nr. 48, datë 08.12.2009, i Ministrisë të Financave, “Për rregullat e shpërblimit të personelit doganor nga të ardhurat që realizohen nga sanksionet e shkeljeve doganore.*
- *Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të sipërcituar do të shkaktonte marrjen e një përfitimi të padrejtë ekonomik nga z. Aliaj, në dëm të buxhetit të shtetit.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo

vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit

në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4335 (80-2016-4340), datë 26.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1235, datë 23.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 06.07.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 162/529 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot, në Tiranë, më **datë 06.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 529/2019**, që i përket:

KËRKUES: Spitali Universitar Obstretik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: **Aleksandër Kito, etj.**

I PADITUR: **Spitali Universitar Obstretik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar pagimin e dëmshpërblimit pasuror dhe jopasuror për dëmtimin e shëndetit të fëmijës Aleksandër Kito.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, ka vendosur:

“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësve Aleksandër Kito, Aristotel Kito, Julian Memaj, Vasil Kito, Flamur Memaj, Eli Memaj, Orsiol Memaj dhe Dorina Memaj.

Detyrimin e palës së paditur Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” të dëmshpërblejë paditësit Aleksandër Kito, Aristotel Kito, Julian Memaj, Vasil Kito, Flamur Memaj, Eli Memaj, Orsiol Memaj dhe Dorina Memaj për dëmin pasuror dhe jopasuror, të shkaktuar nga dëmtimi i shëndetit të fëmijës Aleksandro Kito gjatë lindjes së tij me datë 26.01.2012, si vijon:

1. *Paditësi Aleksandros Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëmin pasuror në vlerën 3.856.298 lekë.*
 - *Dëmin jopasuror: dëm biologjik në vlerën 3.856.298 lekë; dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149.*
2. *Paditësi Aristotel Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm jopasuror: dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzimet spitalore në vlerën 1.478.452 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzime për përkujdesje në vlerën 10.032.000 lekë, shpenzime për këshillime psikologjike në vlerën 4.680.000 lekë, shpenzime për fizioterapi në vlerën 41.610.000 lekë dhe shpenzime për pajisje ortopedike në vlerën 5.520.000 lekë.*
3. *Paditësja Juliana Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm jopasuror: dëm moral në vlerën 1.928.149 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 1.928.149 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzimet spitalore në vlerën 1.478.452 lekë.*
 - *Dëm pasuror për shpenzime për përkujdesje në vlerën 10.032.000 lekë, shpenzime për këshillime psikologjike në vlerën 4.680.000 lekë, shpenzime për fizioterapi në vlerën 41.610.000 lekë dhe shpenzime për pajisje ortopedike në vlerën 5.520.000 lekë.*
4. *Paditësi Vasil Kito të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
5. *Paditësja Eli Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
6. *Paditësi Flamur Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë dhe dëm ekzistencial në vlerën 964.074 lekë.*
7. *Paditësja Orsiola Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë.*
8. *Paditësja Doriana Memaj të dëmshpërblehet për:*
 - *Dëm moral në vlerën 964.074 lekë.*

Rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Shpenzimet gjyqësore dhe ato për vënien në ekzekutim të vendimit në ngarkim të palëve në masën 1/3 paditësit dhe 2/3 pala e paditur.”.

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 2859 (80-2016-2987), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

4. **Kundër vendimit nr. 2590, datë 02.10.2019**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha

Geraldinë”, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

5. **Pala e paditur, Spitali Universitar Obstretik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”**, në datën 26.12.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Kërkimin tonë e motivojmë me drejtësinë dhe bazueshmërinë në prova e në ligj të vendimeve të të dyja gjykatave të faktit, të cilat Gjykata e Lartë ka mundësinë t'i konstatojë gjatë gjykimit të saj dhe ku haptazi ekziston mundësia që kjo vendimmarrje të ndryshojë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i këtij vendimi do të sillte dëme serioze dhe të pariparueshme e pasoja të rënda, të materializuara në vështirësinë e kthimit të kësaj shume pranë buxhetit të shtetit, në rast të ndryshimit të kësaj vendimmarrje pas ushtrimit të të drejtës së ankimit.*
- *Gjithashtu, nga ana e gjykatës duhet të merret parasysh natyra e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, pozita e palës kreditore dhe asaj debitore si dhe natyra dhe vlera e detyrimit që kërkohet të ekzekutohet.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe

gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e saj.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Spitali Universitar Obstretik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2859 (80-2016-2978), datë 06.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2590, datë 02.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 06.07.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 99/435 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot, në Tiranë, më **datë 06.07.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim me **Nr. Akti 435/2019**, që i përket:

KËRKUES: Muharrem Gokovi.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 344, datë 25.02.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimit nr. 2253 (7067), datë 24.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, deri në përfundimin e çështjes.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Myftinia Shkodër.

TË PADITUR: Muharrem Gokovi.
Bashkia Shkodër.
Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke kërkuar pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit të lëshuar nga i padituri Bashkia Shkodër, kthimin

e sendit te paluajtshëm nga i padituri Muharrem Gokovi dhe pavlefshmërinë e regjistrimit të këtij sendi në favor të të paditurit Muharrem Gokovi.

2. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**, me vendimin nr. 2253 (7067), datë 24.09.2012, ka vendosur:

“1. *Pranimin e kërkesëpadisë.*

2. *Detyrimin e të paditurit Muharrem Gokovi që t'i lirojë palës paditëse Myftinia Shkodër sipërfaqen e truallit prej 105 (njëqind e pesë) m², e cila përcaktohet nga pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 sipas planimetrisë nr. 4, të aktit të ekspertimit që bashkëngjitet këtij vendimi.*

3. *Detyrimin e palës së paditur Z.V.R.P.P Shkodër që të fshijë shënimet përkatëse në radhorin e pronësisë nr. 858, datë 08.06.1998.”.*

3. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 344, datë 25.02.2014, ka vendosur:

“1. *Ndryshimin e vendimit nr. 2253 (7076), datë 24.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

2. *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.*

3. *Rrëzimin e padisë për kërkimin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të lejes së ndërtimit nr. 58, datë 14.12.1992, si gjë e gjykuar.*

4. *Lënien në fuqi të vendimit për disponimet e tjera.”.*

4. **Kundër vendimit nr. 344, datë 25.02.2014**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs i padituri Muharrem Gokovi, i cili ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 2253 (7076), datë 24.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dhe rrëzimin e padisë.

5. **I padituri Muharrem Gokovi**, në datën 25.09.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2253 (7076), datë 24.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndryshuar me vendimin nr. 344, datë 25.02.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë dhënë në kundërshtim të hapur me ligjin.*
- *Nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të mësipërm mund të më vijë pasoja të rënda e të pariparueshme.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

13. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

14. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Muharrem Gokovi, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2253 (7076), datë 24.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndryshuar me vendimin nr. 344, datë 25.02.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 06.07.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI